

**“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 14

"Investment Sherko – ikub Group" shpk
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
 Më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	3,648,614	13,431,417
Llogari të arkëtueshme	5	269,069	135,094
Aktive të tjera afatshkurtra	6	15,410,157	4,500,437
Total Aktiveve Afatshkurtra		19,327,840	18,066,948
Aktivët afatgjatë			
Llogari të tjera të arkëtueshme	7	3,063,000	3,380,000
Total aktive afatgjatë		3,063,000	3,380,000
Total Aktive		22,390,840	21,446,948
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	8	2,000,000	2,000,000
Llogari të pagueshme të tjera	9	198,363	165,955
Total Detyrime afatshkurtra		2,198,363	2,165,955
Totali i detyrimeve		2,198,363	2,165,955
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	10	2,000,000	2,000,000
Rezerva të tjera		-	6,321,261
Rezerva ligjore		200,000	-
Fitimi i ushtrimit		17,992,477	10,959,732
Total kapitali aksionar		20,192,477	19,280,993
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		22,390,840	21,446,948

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Investment Sherko – ikub Group" shpk
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Shenime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura	-	-
Materiale te para dhe te konsumueshme	-	-
Shpenzime personeli	13 (659,556)	(722,142)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-	-
Shpenzime te tjera	12 (41,455)	(161,055)
Fitimi operativ	(701,011)	(883,197)
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara	11 18,547,512	11,699,315
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	14 145,976	143,614
Total shpenzime financiare	18,693,488	11,842,929
Fitimi para tatimit	17,992,477	10,959,732
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15 -	-
Fitimi i vitit	17,992,477	10,959,732

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve te Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali themeltar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura /humbje te akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	2,000,000	-	-	6,321,261		8,321,261
Fitimi i vitit					10,959,732	10,959,732
Transferim ne rezerva te tjera		6,321,261		(6,321,261)		
31 Dhjetor 2013	2,000,000	6,321,261	-	-	10,959,732	19,280,993
Fitimi i vitit					17,992,477	17,992,477
Transferim ne rezerva te tjera		(200,000)	200,000			-
Dividendë te paguar		(6,121,261)			(10,959,732)	(17,080,993)
31 Dhjetor 2014	2,000,000	-	200,000	-	17,992,477	20,192,477

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë Investment Sherko – ikub Group shpk dhe u nënshkruan si më poshtë më 23 Mars 2015 nga:

Migena Sherko
Migena Sherko
 Administrator



Ana Qose
Ana Qose
 Hartues i Pasqyrave Financiare

"Investment Sherko – ikub Group" shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014**

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	17,992,477	10,959,732
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Shpenzime për interesa	(143,202)	(3,461)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	17,849,275	10,956,271
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(11,023,694)	(135,927)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	32,408	(61,599)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	6,857,989	10,758,745
Interesa te paguara	143,202	3,461
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit	(20,001)	(32,724)
	123,201	(29,263)
Aktivitetet investuese		
Rritje/renie ne investimet ne pjesemarrje	317,000	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	317,000	-
Aktivitetet financuese		
Dividendë paguar	(17,080,993)	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	(17,080,993)	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(9,782,803)	10,729,482
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	13,431,417	2,701,935
Mjetet monetare ne fund te periudhës	3,648,614	13,431,417

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

" Investments Sherko – ikub Group është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendres Kombëtare të rregjistrimeve me datë 18 Janar 2012 me NIPT L21318042U. Selia e shoqërisë është në Rrugen Ismail Qemali Pallati 27 Shk1 Nr. 30. Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 leke. Përfaqesuesi ligjor i shoqërisë është Znj. Migena Sherko.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Romeo Sherko i cili zoteron 100% të kuotave të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është në fushën e shitjeve të licensave software dhe shërbimeve perkatese të lidhura me to. Dhenia me qira e softwareve. Shërbime të adoptimit dhe të pershtatjes së softwareve. Shërbime suporti dhe mirëmbajtje të teknologjisë së informacionit, shërbime të konsulencës teknike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe aktivitete të tjera të subjekteve private e publike. Shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit etj.

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 1 punonjës (2013: 1 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lek)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Llogari rrjedhese	3,648,614	13,431,417
	3,648,614	13,431,417

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente	269,069	135,094
	269,069	135,094

6. AKTIVE TË TJERA AFATSHKURTËRA

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua te dhena nga ikub.al	4,469,280	4,466,880
Tatimi Mbi Fitimin	52,725	32,724
TVSH	833	833
Tatim mbi dividendin	746,652	
Financim per ikub.al	3,020,800	
Romeo Sherko	6,719,867	
Pragmatic Software	400,000	
	15,410,157	4,500,437

7. Llogari te tjera te arketueshme

Ne llogarite e tjera te arketueshme paraqiten Investimet ne pjesemarrje qe kompania zoteron ne kompanite tjera :

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Intelligent Systems Albania	980,000	980,000
ikubINFO Software Solutions	400,000	400,000
ikub.al	1,600,000	2,000,000
ikubINFO	83,000	-
	3,063,000	3,380,000

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

8. HUA AFATSHKURTRA

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatshkurtra. Më poshtë janë paraqitur këto hua më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Hua nga Ortaku	2000,000	2,000,000
	<u>2,000,000</u>	<u>2,000,000</u>

9. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga per t'u paguar	50,000	100,000
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	1,837	
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	3,126	5,555
Financim nga ortaku	60,400	60,400
ikubINFO Software Solutions	83,000	-
	<u>198,363</u>	<u>165,955</u>

10. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore është në vlerën 200,000 Leke.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 17,990,636 leke perfaqeson fitimin e vitit te mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

11. TË ARDHURA FINANCIARE

Të ardhurat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga dividendet	18,547,512	11,699,315
	<u>18,547,512</u>	<u>11,699,315</u>

Rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar ne FDP e TVSH eshte si me poshte:

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

	<u>Dhjetor 2014</u>
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	134,473
Autofatura	-
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	134,473
Shitje sherbime	134,473
Te ardhura te deklaruar ne Pash qe jane deklaruar shitje ne FDP	134,473
Te ardhurat nga interesat	8,730
Fitim nga kembimet valutore	2,819
Te ardhura te tjera financiare	18,547,512
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	18,693,533

12. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TE TJERA FINANCIARE

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga interesat	143,202	138,555
Diferenca pozitive nga kursi I kembimit	2,819	5,059
Diferenca negative nga kursi I kembimit	(46)	-
	145,976	143,614

13. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	648,528	690,351
Shpenzime per sigurime shoq e shend	11,028	31,791
	659,556	722,142

14. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane te analizuara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime materiale	-	4,167
Komisione bankare	15,853	17,016
Tatime te tjera	25,120	119,620
Gjoba dhe penalitete	482	20,252
	41,455	161,055

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

15. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	<u>31 Dhjetor 2014</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2013</u> ne Lek
Fitimi Para Tatimit	17,992,477	10,959,732
Minus		
Te ardhura nga Dividentet nga investimet ne pjesemarrje	(18,547,512)	(11,699,315)
Shpenzime te pazbritshme	482	
Fitimi Fiskal	(554,553)	(739,583)
Tatimi Mbi Fitimin (15%/10%)	-	-
	<u>31 Dhjetor 2014</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2013</u> ne Lek
Tatimi Mbi Fitimin I parapaguar me 1 janar 2014/2013	32,724	-
Tatim Fitimi I Parapaguar 2014/2013	20,001	32,724
Tatim Fitimi 2014/2013	-	-
Tatim Fitimi I parapaguar/Per tu paguar	52,725	32,724

Te ardhurat e marra nga dividendet nga Investimet ne pjesemarrje nuk merren ne konsiderate në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, sipas nenit 26 te Ligjit 8438 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.

16. PALËT E LIDHURA

Gjendjet dhe e llogarive me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë të detajuara si më poshtë:

Te pagueshme ndaj paleve te lidhura

Hua te marra

	<u>31 Dhjetor 2014</u> ne Lek
Romeo Sherko	2,060,400
IKUBINFO Software Solution	83,000
Totali	2,143,400

Te arketueshme nga palet e lidhura

"Investment Sherko – ikub Group" shpk
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Te arketueshme tregtare

	31Dhjetor2014
	neLek
ikubal	269,069
Totali	269,069

Hua te dhena

	31Dhjetor2014
	neLek
Pragmatic Software	400,000
IKUBAL	7,490,080
Romeo Sherko	6,719,867
Totali	14,609,947

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

17. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

18. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.